REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 114/20
Datë/Datum. 18.02.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komunës së Prishtinës**

Nr. i prokurimit: *616 19 130 222*

Sa i përket tenderit për: **"Sherbimet e konsulences ne fushen e kulturës-ritender"**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"Albo Group" SH.P.K & **"EKOVIZIONI"**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Hyzri Talla nr.16,
(Adresa)

Prishtinë — ***10000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044-469 686
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Albonë Rruku
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

albogroup19@gmail.com
(Adresa elektronike)

18.02.2020
(Data e parashtrimit të kërkesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH. P. K. Albo Group Prishtinë

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 17.10.2019
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 03.01.2020, ora 13:00
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 03.02.2020
Kërkesa për rishqyrtim në AK: 07.02.2020
Vendimi i rishqyrtimit: 10.02.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Në ftesën e dërguar për dorëzim të ofertës për fazën e dytë shkruan:

Tenderët duhet te dorëzohen ne adresën e specifikuar në pjesën A "Procedurat e Tenderimit para **03.01.2020** në **13:30:00** orë

Me që në ftesë te ora ka një orë jo të qartë kurse pjesa e cekur ti referohemi pjesës A në procedurat e tenderimit, ne ju kemi referuar pjesës A dhe ku shkruan qartë se dorëzimi i

ofertave bëhet para ore 13:00.

Në bazë të DT, ftesë së dërguar dhe publikimit koha për dorëzimin e tenderëve ka qenë në ora 13:00, gjë që ë dëshmon edhe procesi i pranimit po ashtu dhe procesi i hapjes ku kemi jap vërejtje se OE "Base Agency" shpk , ka dorëzuar ofertën pas kalimit të kohës.
Më pas ka ndërhyrë AK edhe në platformën elektronike duke ndryshuar kohën e dorëzimit të ofertave nga ora 13:00 në ora 13:30.

Që nga ky moment shifet haptas dëshira e AK për të i ndihmuar me çdo kusht OE "Base Agency" shpk, duke e shkelur ligjin e Prokurimit Publik me të dyja këmbët.



Shifet procesi i hapjes se si zyrtari i pranimit e ka mbyll një herë procesin dhe pasi që e ka mbyll pas orës 13:00, kur vjen edhe OE i propozuar për kontratë e pranon me rekomandimin e kujt ai e di, mbetet të shifet në institucionet e tjera.
Po ashtu bashkangjitur është edhe procesi i hapjes me vërejtjen qe e ka shkruar OE "Rea Prishtina" gjë për të cilën u pajtuam të gjithë si ne OE ashtu edhe zyrtarët e prokurimit që oferta e OE "Base Agency" shpk është dorëzuar pas afati.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 5 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së
Neni 44 i LPP-së
Neni 58 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 37 i RRUOPP-së
Neni 39.8 i RRUOPP-së

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Të nderuar AK na keni njoftuar me letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm me dt.03.02.2020 lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ku kanë theksuar se ne nuk kemi marr as 70 pikë, por kemi marr vetëm 44.66 pikë nga 100 pikë të kësaj faze.

Ju sqarojmë se ne jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit sepse AK, e kanë shpallur si tenderues të suksesshëm OE "Base Agency" shpk i cili ka dorëzuar ofertën pas afati të caktuar nga AK.
Ky OE është dashur të mos vlerësohet fare sepse nuk i ka përfillur afatet kohore të dorëzimit. Nuk ka plotësuar kushtet administrative.

OE nuk ka plotësuar fare aneksin C në metodologji sipas kërkesave të FDT-së.

Te vlerësimi nga komisioni i AK:
Shihet se kanë bërë shkelje të mëdha sepse disa pika nuk mund të zbriten pikë, kur janë në rregull, nuk ka pasur pikë minimale dhe maksimale psh te stafi, ku ne është dashur të marrim 40 pikë me që i kemi të gjithë stafin dhe më shumë se që është kërkuar nga AK e jo të i marrim 15.66 siç i kemi marr. Në këtë pikë është dashur OE fitues ti ketë vetëm 30 pikë e jo 40 sepse dy nga stafi i kërkuar nuk i plotësojnë kriteret minimale Dizjaneri Grafik dhe Fotografi.

Te metodologjia vërejtjet e komisionit janë qesharake sepse pjesa me gabime gramatikore dhe gjuhësore ka qenë pjesë e dosjes e dërguar nga AK, kështu që anëtaret e komisionit nuk kanë ditur se çfarë kanë vlerësuar, përveç qëllimit që te japin pikë pak dhe të jetë me pikë maksimale OE i tyre i preferuar.
Kur dihet haptas se qasja teknike dhe metodologjia, plani i punës si dhe organizimi dhe stafi, të paraqitura në ofertën tonë janë dukshëm më të mirë se sa OE fitues.

Pikët

i) Përvoja specifike e Konsulentit në lidhje me angazhimin: ***10*** *(mund të vlerësohet diç me pikë)*

ii)Përshtatshmëria e Metodologjis se propozuar dhe planit të punës në përgjigjen ndaj Termave të Referencës:

a) Qasja teknike dhe metodologjia: *20 (mund të vlerësohet diç me pikë)*
b) Plan i punës: *20 (mund të vlerësohet diç me pikë)*
c) Organizimi dhe stafi: *10 (mund të vlerësohet diç me pikë)*

Pikët totale për kreterium (ii): ***50***

(iii) Kualifikimet dhe kompetencat e stafit kryesorë për angazhim:

a) **[Dizajneri grafik** *5 pike* *(nuk ka pik minimale dhe maximale)*
b) **[Editor i rrjeteve sociale** *10 pike* *(nuk ka pik minimale dhe maximale)*
c) **[Video editor/montazher** *5 pike* *(nuk ka pik minimale dhe maximale)*
d) **Kameraman** *5 pike* *(nuk ka pik minimale dhe maximale)*
e) **Fotograf Shkrues i teksteve** *5 pike* *(nuk ka pik minimale dhe maximale)*
f) Kordinator/e i/e aktiviteteve/eventeve *10 pike* *(nuk ka pik minimale dhe maximale)*

Pikët totale për kreterium (iii): ***40***

Pikët totale për katër kriteret: 100

Te stafi vlen rregulla e ka apo nuk e ka, e ka i merr pikët, nuk e ka nuk i merr pikët.

Dy ekspertë të paraqitur nga OE fitues nuk i plotësojnë kriteret e kërkuar në dosjen e tenderit:

- **Dizajneri grafik:**
  Kërkohet në dosjen e tenderit:
  Të ketë të përfunduar fakultetin e dizajnit grafik apo diçka relevante me fushën
  Arjan Halili, i paraqitur për këtë pozitë nga OE fitues, nuk e ka të përfunduar fakultetin fare, e as nuk është i regjistruar në drejtim përkatës.
  Gjë të cilën ne e kemi me fakultet përkatës.

- **Fotograf:**
  Kërkohet në dosjen e tenderit:
  Të ketë të përfunduar fakultetin, ose të ketë përvojën ekuivalente
  Andrit Kastrati, i paraqitur për këtë pozitë nga OE fitues, nuk e ka të përfunduar fakultetin fare, e as nuk është i regjistruar në drejtim përkatës.
  Gjë të cilën ne e kemi me fakultet përkatës.

Neni 39.8 i RRUOPP-së thotë:

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat
Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, ndërsa ne është dashur të shpallemi si tenderues fitues i këtij aktiviteti të prokurimit, sepse jemi ofertues i përgjegjshëm.

Gjithashtu ju si AK nuk e keni respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për

kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi.

Gjithashtu ju si autoritet kontraktues nuk i keni respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga ju që të shqyrtoni Ankesën tonë në mënyrë meritore dhe të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa OE **"Albo Group" SH.P.K & "Ekovizioni"**
ANULOHET, vlerësimi i komisionit dhe të vlerësohen pikët pa anime,
dhe lënda kthehet në **RISHQYRTIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 10,000.00 euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.